



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
02 Nr. 400/01-28613 Dt. 30.07.2020

Shkresë	30.07.2020
Nga:	U.D. ZPP BLERIM NIKA
Lenda :	VENDIM

Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik nr 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin nr 05/L-92 Ligji mbi Prokurimin publik ne Kosovë,përkatesisht neni 108/A pika 2 dhe neni 6 pika 1 e Rregullave për parashtrimin e kërkesave për Rishqyrtim ,Zyra e Prokurimit në Drenas nxjerrë :

VENDIM

- 1.Refuzohet Kërkesa për Rishqyrtim të Aktivitetit te Prokurimit me titull "Furnizim me Instrumente Gjeodezike per Matje, GPS-Rover dhe Total Station" me nr. Prokurimi 611-20-063-121 I dt. 17/07/2020 si e pa bazuar .
- 2.Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim është i bazuar në gjendjen reale të zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Pyetjet nga OE:

1. Saktësia ne Plane 1cm dhe ne Kuot 2cm! për cfarë linje baze është kërkuar Kjo Saktësi?. Ne matjet me GPS kjo specifik është absurde, ne asnjë broshure prodhuesit nuk jepet një specifik e tillë. Për më tepër ju keni kërkuar një antene GNSS e cila do te lidhet me sistemin KOPOS dhe do te marr korrektuar 1ne kohe reale, saktësia qe KOPOS ofron ne kohe reale është brenda intervalit 2 cim -4 Cm, ndersa ju keni kërkuar 1 cm!!! Poshtëshënuar e keni tabelën dhe linkun ku sqarohet saktësia qe ofron KOPOS ne kohe reale nga faqja e AKK-se (Agjencia Kadastrale e Kosoves).

Lloji i shërbimit	Përshkrimi	Rangu i Saktësisë
RTK	Saktësi e lartënë kohë reale (RTK)-Phase	0.02-0.04 m

Tabela 5. Shërbimet e sistemit KOPOS

Linku per saktësin qe ofron kopos: <http://www.kca-ks.org/libraria.jsessionid=3D0681ED5224EA34E96976F759FA698F>

Burimi I informacionit: Korniza e punës 2020/01, Faqe: 48

2. GPS dhe Stacioni Totala duhet te jene te te njejtit prodhues, apo mund te sjellim nga prodhues te ndryshem nje kinez dhe nje europian!?

3. Numri i Kanale mbi 300, pse jo mbi 200!?

4. GPS i integruar ne Stacion total, cfare nenkupton? A duhet te punoj si nje i vetem, ju lutem te na jepni me shume detaje rreth kesaj!?

5. Rrezja e matjes me reflektor deri ne 10000m??? A mendoni qe do ketë fushëpamje deri ne 10km matje? A është vërtet e nevojshme?

6. Definim i lartësisë se Stacionit, Automatike? A e dini qe me këtë specifik teknike largoni çdo prodhues përpos njerit qeju keni përzgjedh tashme Leica!?

7. Driverat! Çfarë është kjo?

8. Butoni i matjes! Me definim te dyfishte, për çfarë definimi te dyfishte behet fjale?

8. Butoni i matjes! Me definim te dyfishte, për çfarë definimi te dyfishte behet fjale?

9. Stacioni Total i integruar ne GPS!!! Si mund te integrohet totali ne GPS, nje sqarim me te qarte!.

PËRGJIGJËJE NGA AK:

Pyetja 1: pse eshte kerkuar saktesia RTK 1CM Plan dhe 2CM quote.

Pergjigja 1: Ne nuk kemi hasur asnje GPS, te asnje prodhuesi qe nuk permbush kete kerkese.

Cdo GPS, pamvaresisht nga prodhuesi e ka kete specifikim ne datasheet me te mire se kerkesa 1CM plan dhe 2CM ne kuote.

Kjo kerkese nuk perjashton asnje GPS.

Pyetja 2: GPS dhe stacioni total a mund te jene nga i njeiti prodhues apo apo mund te sjellim nga prodhues te ndryshem nje kinez dhe nje europian.

Pergjigja 2: Prodhues te GPS dhe Stacionit Total mund te jene te ndryshem.

Nuk mund te jene te ndryshem prodhuesit brenda te njetit produkt psh.

Antena/marresi i GPS: prodhues „X”

Kontrolleri i GPS: prodhues „Y”.

Software i GPS: prodhuesi „Z”

Nese prodhuesi X, Y dhe Z jane prodhues te te njejtit Korporate-apo Konzorcium atehere keta do te konsiderohen si prodhues i njejte.

Pyetja 3: Nr. Kanaleve mbi 300, pse jo mbi 200?

Pergjigja 3: Sepse, ne rast se do kishim kerkuar 200, pyetja do ishte pse jo 100?

Sepese, nga studimi i specifikimeve teknike te GPS te ndryshem te prodhuesve te ndryshem, ne kemi konstatu qe GPS e prodhimeve te reja tek te gjithe prodhuesit

kane mbi 300 kanale dhe ne kemi dash me i hap rruge prodhimeve te reja. Te gjithë prodhuesit pa perjashtim kane ne program GPS me mbi 300 kanale. Nuk kemi has prodhues qe nuk ka ne program GPS me mbi 300 kanale. GPS ndahen sipas hulumtimit tone ne dy grupe kryesore: grupi basic nen 230 kanale dhe grupi i avancuar me mbi 300 kanale.

Ulja e nr. te kanaleve do i hapte rruge prodhimeve basic, qe jane kryesisht produkte te thjeshta. Kjo kerkese plotesohet nga cdo prodhues. me kete kerkese nuk i eshte mbyllur mundesia asnje prodhuesi.

Ky kriter do te konsiderohet perjashtues, po qe se nuk plotesohet!

Pyetja 4: GPS i integruar ne stacion total.....na jepni me shume spjegime per kete.

Pergjigja 4: Ne tregun kosovar prej kohesh eksistojne produkte ku marresi i GPS mund te vendoset ne Stacion Total, dhe mundeson stacionimin e stacionit ne vend ku nuk ka pika te njohura. Kjo zgjidhje nuk eshte e re, por shume e vjeter ne treg, qe para 10-15 vjetesh.

Kjo e lehteson gjeodetin dhe i kursen kohe atij ne pune te caktuara.

Shenim: kjo kerkese nuk eshte perjashtuese, por merr vleresim po qe se ndonje operator ekonomik e ofron.

Pyetja 5: Rrezja e matjes me reflektor deri ne 10000m?

Pergjigja 5: Ne kemi qellim te marrim produkt sa me te mire me kete buxhet te vogel qe kemi. Ne ne datasheete te ndryshme kemi dallu per kete specifikim 3000m, 4000m,10000m. Eshte kuptueshme nje produkt qe ka mundesine deri ne 10000m bazohet ne nje teknologji me te larte, e cila e mundeson kete dhe nje tjeter qe ka rreze me te vogel bazohet ne nje teknologji me pak te avancuar.

Pastaj me siguri qe ne momente te caktuara do te na duhet. Jo per cdo dite, por here pas here edhe mundet. Ne presim qe ky produkt te na kryje pune edhe ne 2030. Kush mund te thote sot cilat do jene nevojat gjeodezike per 2030? Ne mundohemi me pa para. jo prapa.

Shenim: kjo kerkese nuk eshte perjashtuese, por do vleresohet si duhet.

Pyetja 6: Lartesia automatike?

Pergjigja 6: Zhvillimi i teknologjise gjeodezike ka shkon duke e shmang gabimin njerezor. Ne intergeo 2019, po edhe ne webpage kemi pa stacion total me lartesi automatike.

Kjo specifike eshte shume e rendesishme per saktesine dhe sigurine e matjeve dhe lehteson shume punen e gjeodetit ne terren. E ardhmja e total stacioneve eshte lartesia automatike. Para disa vite centrimi laserik ishte specifikim vetem i nje prodhuesi, por pas disa vitesh te gjithë stacionet, pamvaresisht nga prodhuesi kalun ne centrim laserik. Po keshtu edhe lidhja e kontrollerit dhe antenes se GPS me Bluetooth. Ne fillim e ka ofru vetem nje prodhues, pas nje viti e ofruan te gjithë prodhuesit. Prej vitesh nuk ofron kush GPS me kabell.

Ne jemi te ndergjegjshem qe stacion me specifikime te reja ne treg kushtojne shume, dhe buxheti yne ndoshta nuk eshte i mjaftueshem per blerjen e nje stacioni kaq te perparuar, por ne duhet me tentu me te miren e mundshme per komunen tone. E po qe se nuk ofron asnje operator ekonomik per aresye buxheti, ne do vendosim me zgjedh midis atyne qe do na mundesoje tenderi, dhe do zgjedhim me te lirin e pergjegjshem. Por ne duam te nxisim Operatoret Ekonomik te ofrojne instrumenta bashkekohore dhe me performance sa me te larte.

Shenim: ky specifikim nuk eshte perjashtues, por do te vleresohet si duhet.

Pyetja 7: Driverat! Cfare eshte kjo?

Pergjigja 7: Ne gjuhen profesionale gjeodezike rotullamet qe bejne levizjen vertikal te dylbis dhe horizontal te instrumentit thirren „driver” nga anglishtja rotullus ose rotullam - Vida (ashtu i si trekembshi thirret tripod ose stativ dhe bazamenti i instrumentit thirret trigger ose tribrach)

Pyetja 8: Butoni i matjes me definim te dyfishte. Per cfare definimi te dyfishte behet fjale?

Pergjigja 8: Butonat ose tastet e stacionit total kane secili funksion te percaktuar nga prodhuesi, por ka prodhues qe vendosin buton te lire me nje ose me dy funksione te lire, qe perdoruesi i percakton vet cfare funksioni do me i caktu. Kjo rrit shpejtesine e matjeve ne terren. Kjo rrit edhe rendimentin e punes ne terren. Ne kemi prej vitesh stacion me buton te lire me dy funksione. Ne nuk duam qe te blejme stacion me me pak performace nga ato qe kemi.

Pyetja 9: Stacioni Total I integruar ne GPS!!! Si mund te integrohet totali ne GPS, nje sqarim me te qarte!.

Pergjigja 9: Pergjigja është dhënë ne pytjen me numer 6.

Verejtje profesionale:
per cdo kerkese vien shenimi „EKUIVALENT”. Kjo e hap konkurrencen maksimale.

Burimet tona te hulumtimit paraprak kane qene:

1. Webpages:

Leica,
Trimble,
Topcon-Sokkia,
GeoMax,
Spectra,
Nikon,
Pentax
Stonex,
Hi-target,
Foof,
South

2. Intergeo 2019 Gjermani.

Pala e paknaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në OSHP

Me respekt
Zyra e Prokurimit , Drenas
30.07.2020